

AWO Kreisverband Nürnberg e.V.

Newsletter

Buletin informues

Die AWO Nürnberg ist seit fast 20 Jahren im Kosovo tätig und betreibt in Prishtina ein eigenes Büro seit 2009, in dem Rückkehrer*innen aus Deutschland umfassend beraten und unterstützt werden. Seitdem ist eine weitere Anlaufstelle in Prizren hinzugekommen.
Mit dem aktuellen Projekt KOMPASS wird unser Angebot fortgeführt und ausgebaut. Daneben hat sich unsere Tätigkeit seit 2021 mit dem Vorintegrationsprojekt „Hallo Deutschland“ erweitert. Wir möchten unsere Förder- und Netzwerkpartner sowie alle weiteren Interessierten regelmäßig über diesen Newsletter zu Neuigkeiten aus unserer Projektarbeit auf dem Laufenden halten und Einblick in aktuelle Fälle und Aktivitäten geben.

AWO Nürnberg është aktive në Kosovë prej gati 20 vitesh dhe që nga viti 2009 operon me zyrën e saj në Prishtinë, ku u ofron këshillim dhe mbështetje gjithëpërfshirëse personave të kthyer nga Gjermania. Më vonë është hapur edhe në Prizren. Me projektin aktual KOMPASS, puna jonë vazhdon dhe zgjerohet më tej. Përveç kësaj, që nga viti 2021, veprimtaria jonë është zgjeruar edhe me projektin e para-integrimit “Hallo Deutschland”. Përmes këtij buletini informues duam që të ju mbajmë rregullisht të informuar si partnerët tanë mbështetës dhe të rrjetit, si dhe të gjithë të interesuarit e tjerë, mbi zhvillimet më të reja të punës sonë në kuadër të projekteve dhe t’u ofrojmë një pasqyrë mbi rastet dhe aktivitetet aktuale.

INHALT

Aktuelles aus den Projekten
Lajmet më të fundit nga projektet

Ein Schulranzen, ein Neuanfang S.2
Një çantë shkollore, një fillim i ri f.2

Der AWO Bundesverband zu Besuch im Kosovo S.4
Shoqata Federale AWO viziton Kosovën f.4

Einblick in aktuelle Fälle
Pasqyrë e rasteve aktuale

Mit Schreinerhandwerk und Näherei zurück in den Arbeitsmarkt S.3
Me zanatin e zdrukthëtarisë dhe qepjes drejt riintegrimit në tregun e punës ***f.3***

Vernetzung und Kooperation
Rrjetëzimi dhe bashkëpunimi

Schulung zur Supervision von Praktikanten der Universität Prishtina S.6
Trajnim dhe Supervisioni i praktikantëve nga Universiteti i Prishtinës f.6

Unsere Gruppenangebote
Aktivitetet tona në grup

Sommeraktivitäten für Kinder, Jugendliche und Mütter im Rahmen des Projekts KOMPASS S.7
Aktivitete verore për fëmijët, të rinjtë dhe nënat në projektit KOMPASS f.7



Ein Schulranzen, ein Neuanfang

Im Rahmen des KOMPASS- und LfAR-Projekts wurde eine Hilfsaktion für bedürftige Kinder aus Familien durchgeführt, die aus Deutschland zurückkehrten. Mit großem Engagement wurden Schulranzen gekauft und gepackt, anschließend mit den notwendigen Schulmaterialien befüllt und an die Kinder verteilt.

Neben der materiellen Unterstützung möchte diese Initiative den Kindern eine wichtige Botschaft vermitteln: Sie sind nicht allein und die Gemeinschaft die Gemeinschaft steht ihnen zur Seite. Mit dieser Aktion trägt KOMPASS und das LfAR dazu bei, bessere Chancen für Kinder zu schaffen und die zurückkehrenden Familien bei der Wiedereingliederung in Kosovo zu unterstützen.

Një çantë shkollore, një fillim i ri

Në kuadër të projektit KOMPASS dhe LfAR, u realizua një aktivitet mbështetës për fëmijët në nevojë nga familjet e kthyera nga Gjermania. Me shumë përkushtim, u blenë dhe u përgatitën çantat shkollore, të cilat më pas u mbushën me materiale të nevojshme për shkollë dhe iu shpërndanë fëmijëve.

Përtej mbështetjes materiale, kjo nismë synon t'u përcjellë fëmijëve një mesazh të rëndësishëm: se ata nuk janë vetëm dhe se komuniteti është pranë tyre. Me këtë aktivitet, KOMPASS dhe LfAR kontribuon në krijimin e mundësive më të mira për fëmijët dhe në mbështetjen e familjeve të kthyera në procesin e riintegrimit në Kosovë.





Mit Schreinerhandwerk und Näherei zurück in den Arbeitsmarkt



Eine erfolgreiche Reintegration kann so aussehen: Eine vierköpfige Familie kehrte im Jahr 2025 freiwillig in den Kosovo zurück. Die Familie stand vor der Herausforderung, sich vor Ort eine nachhaltige wirtschaftliche Existenz aufzubauen und sich wieder in den lokalen Arbeitsmarkt zu integrieren.

Dank unseres Projekts KOMPASS sowie der zusätzlichen finanziellen Unterstützung des LfAR für rückkehrende Personen, konnten sowohl der 36-jährige Familienvater als auch seine 35-jährige Ehefrau jeweils eine sogenannte „Miniexistenzgründung" realisieren.

Der Familienvater stellt Möbel im Rahmen seines Schreinerhandwerks her. Durch das Projekt KOMPASS erhielt er die erforderlichen Arbeitsmittel, die ihm den Zugang zum Arbeitsmarkt erleichterten und einen schnelleren sowie sichereren Einstieg in die berufliche Tätigkeit ermöglichten. Seine Ehefrau ist inzwischen als Näherin tätig. Für die Ausübung ihrer Tätigkeit steht ihr unter anderem eine professionelle Nähmaschine zur Verfügung, die durch das Projekt LfAR finanziert wurde.

Diese Familie ist ein gelungenes Beispiel für nachhaltige Reintegration. Indem beide Ehepartner gemeinsam zum Lebensunterhalt der Familie beitragen, schaffen sie sich eine langfristige Lebens- und Berufsperspektive im Kosovo.



Me zanatin e zdrukthëtarisë dhe qepjes drejt riintegrimit në tregun e punës

Një riintegrim i suksesshëm mund të duket kështu: Një familje katëranëtarëshe u kthye vullnetarisht në Kosovë në vitin 2025. Familja u përball me sfidën e krijimit të një baze të qëndrueshme ekonomike dhe të riintegrimit në tregun vendor të punës.

Falë mbështetjes financiare nga projekti jone Kompass dhe LfAR per personat e riatdhesuar, si kryefamiljar i shtëpisë (36-vjeçar), ashtu edhe bashkëshortja e tij (35-vjeçare), përfituan nga financimi për krijimin e një mikro-biznesi. Kryefamiljari bën prodhimin e mobilieve në kuadër të zanatit të zdrukthëtarisë ku përmes projektit Kompass ka përfituar mjete pune që i kanë lehtësuar qasje më të shpejt dhe të sigurtë në tregun e punës, ndërsa bashkëshortja e tij tashmë punon si rrobaqepëse. Për ushtrimin e këtij aktiviteti, ajo disponon, ndër të tjera, një makinë profesionale qepjeje, e cila është financuar nga projekti LfAR.

Kjo familje përbën një shembull të suksesshëm të riintegrimit të qëndrueshëm, pasi bashkëshortët, duke kontribuar së bashku në sigurimin e të ardhurave për familjen, po krijojnë një perspektivë afatgjatë jetese dhe punësimi në Kosovë.



Der AWO Bundesverband zu Besuch im Kosovo

Im Juli 2026 besuchten uns vom AWO Bundesverband die Vorständin Claudia Mandrysch und Lorenz Wiese der Abteilungsleiter für Migration und interkulturelle Öffnung. Innerhalb von vier Tagen wurde ein straffes Programm absolviert, bei dem viele interessante Gespräche stattfanden:

Als Vertreterinnen und Vertreter der kosovarischen Behörden tauschten wir uns mit Defrim Rifaj, Direktor der Abteilung Arbeit und Beschäftigung im Ministerium für Arbeit und Soziales im Kosovo aus. Er berichtete über die nach wie vor angespannte wirtschaftliche Situation des Kosovo und die damit verbundenen Startschwierigkeiten auf dem Arbeitsmarkt für Rückkehrende. Auch die Abwanderung von Fachkräften aus dem Kosovo nach Deutschland wurde in diesem Gespräch diskutiert und sowohl der Aspekt des Verlusts von qualifizierten Kräften als auch die Chancen für die Personen diskutiert. Die Beratung der Rückkehrenden und der Fachkräfte von Seiten der AWO, wurde als wichtiges Angebot zur Eingliederung in den Arbeitsmarkt gesehen. Kushtrim Nreci, Direktor für Integration und Flüchtlinge des kosovarischen Innenministeriums erläuterte die Situation der Rückkehrenden und die Möglichkeiten der kosovarischen Regierung, diese zu unterstützen. Herrn Nreci betonte die Wichtigkeit der Zusammenarbeit der für die Rückkehrenden zuständigen Regionalkoordinatoren und der AWO Beratungsstelle. Die beiden Programme greifen ineinander und ergänzen sich zum Wohl der zurückgekehrten Familien.

Shoqata Federale AWO viziton Kosovën

Në korrik të vitit 2026, na vizituan përfaqësues të Shoqatës Federale AWO: anëtarja e bordit Claudia Mandrysch dhe Lorenz Wiese, Drejtues i Departamentit për Migracionin dhe Hapjen Ndërkulturore. Gjatë katër ditëve u realizua një agjendë e ngjeshur, gjatë së cilës u zhvilluan shumë biseda interesante:

Në cilësinë e përfaqësuesit të autoriteteve kosovare, zhvilluam bisedime me Defrim Rifajn, Drejtor i Departamentit për Punë dhe Punësim në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale të Kosovës. Ai përshkroi situatën ekonomike vazhdimisht të vështirë në Kosovë, si dhe sfidat fillestare me të cilat përballen të kthyerit gjatë hyrjes në tregun e punës. Për më tepër, u trajtua çështja e emigrimit të punëtorëve të kualifikuar nga Kosova drejt Gjermanisë; ky diskutim përfshiu si humbjen e personelit të kualifikuar, ashtu edhe mundësitë që krijohen për individët në fjalë. Këshillimi që ofrohet nga AWO për personat e kthyer dhe punëtorët e kualifikuar u vlerësua si një burim i rëndësishëm për integrimin e tyre në tregun e punës. Kushtrim Nreci, Drejtor për Integrim dhe Refugjatë në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës, shpjegoi situatën me të cilën përballen personat e kthyer, si dhe masat që po ndërmerr Qeveria e Kosovës për t'i mbështetur ata. Z. Nreci theksoi rëndësinë e bashkëpunimit midis koordinatorëve rajonalë, përgjegjës për personat e kthyer, dhe qendrës së këshillimit të AWO-së. Të dy programet funksionojnë në mënyrë të ndërlidhur, duke plotësuar njëri-tjetrin në dobi të familjeve që janë kthyer.

Aktuelles aus den Projekten *Lajmet më të fundit nga projektet*



Der Vertreter der Gemeinde Gjakovë Herr Armend Behluli berichtete vor allem über bürokratische Hürden, die bei der Wiedereingliederung in die kosovarische Gesellschaft Probleme bereiten. Hiervon betroffen sind vor allem Menschen, deren Staatsangehörigkeit nicht eindeutig zuordenbar ist und die trotzdem in den Kosovo zurückkehren (müssen).

Beim Besuch der deutschen Botschaft diskutierte die Delegation mit dem Botschafter Herrn Rainer Rudolph über die politische Lage des Kosovo und die Situation der Menschen, die in sozialer Not sind. Zudem konnten wir die Inhalte des Projekts „Kompass" für Rückkehrende und des Vorintegrationsprojekts „Hallo Deutschland" erläutern. Im Nachgang zu diesem Besuch war Herr Rudolph im Büro der AWO im Kosovo und hat sich intensiv über deren Arbeit informieren lassen.

Um einen Eindruck von der Arbeit mit den Rückkehrenden zu bekommen wurden Familien besucht, die z.B. mit Lebensmitteln und Einrichtungsgegenständen, sowie Hilfen bei Behördengängen unterstützt wurden. Hierbei wurde die prekäre Lage deutlich und somit auch die dringende Notwendigkeit des Hilfsangebotes des AWO Projekts. Herr Dashnim Bajrami, Vertreter der Minderheiten im Gemeinderat Fush Kosove, erläuterte uns eindringlich die Lebenswirklichkeit des überwiegend von Minderheiten bewohnten Ortes Fush Kosove. Die teilweise fehlende Kanalisation, der schlechte bauliche Zustand der Häuser, sowie die hohe Arbeitslosigkeit bestimmen dort den Alltag. Er setzt sich für eine Verbesserung der Wohnsituation und der Infrastruktur ein.

Neben den Terminen mit Behördenvertreter*innen lernten Frau Mandrysch und Herr Wiese die Arbeit der AWO im Kosovo kennen. Mit den Teams in Prishtina und Prizren diskutierten sie die Herausforderungen der beiden Projekte, sowie Zukunftsperspektiven für die Aktivitäten der AWO im Kosovo.

Përfaqësuesi i Komunës së Gjakovës, z. Armend Behluli, foli kryesisht për pengesat burokratike që krijojnë vështirësi për riintegrimin në shoqërinë kosovare. Kjo prek veçanërisht individët, shtetësia e të cilëve nuk mund të përcaktohet qartë, por të cilët, megjithatë, kthehen – ose detyrohen të kthehen – në Kosovë.

Gjatë vizitës në Ambasadën Gjermane, delegacioni diskutoi me ambasadorin, z. Rainer Rudolph, mbi situatën politike në Kosovë dhe rrethanat e personave që përballen me vështirësi sociale. Për më tepër, patëm mundësinë të shpjegonim detajet e projektit të kthimit "Kompass" dhe projektit të para-integrimit "Hallo Deutschland". Pas kësaj vizite, z. Rudolph vizitoj zyrën e AWO-së në Kosovë, ku u njoh më hollësisht me punën e kësaj organizate.

Për të krijuar një pasqyrë më të qartë mbi punën me personat e kthyer, u realizuan vizita në familje që kishin përfituar mbështetje – duke filluar nga ndihmat ushqimore e orenditë shtëpiake, e deri te ndihma për të kaluar procedurat administrative. Këto vizita nxorën në pah situatën e tyre të vështire, duke theksuar nevojën urgjente për mbështetjen që ofrohet përmes projektit AWO. Dashnim Bajrami, përfaqësues i grupeve minoritare në Këshillin Komunal të Fushë Kosovës, dha një përshkrim të gjallë të realitetit të jetesës në Fushë Kosovë – një qytet i banuar pjesrisht nga grupe minoritare. Jeta e përditshme atje shoqërohet nga sfida të mëdha, si mungesa e pjesshme e sistemit të kanalizimeve, gjendja e dobët strukturore e ndërtesave të banimit dhe shkalla e lartë e papunësisë. Ai po angazhohet në mënyrë aktive për të përmirësuar kushtet e jetesës dhe infrastrukturën lokale.

Përveç takimeve me përfaqësues të qeverisë, znj. Mandrysch dhe z. Wiese u njohën me punën e AWO-së në Kosovë. Së bashku me ekipet në Prishtinë dhe Prizren, ata diskutuan mbi sfidat me të cilat përballen të dyja projektet, si dhe mbi perspektivat e ardhshme për aktivitetet e AWO-së në Kosovë.

Schulung zur Supervision von Praktikanten der Universität Prishtina

Im Rahmen der Zusammenarbeit zwischen AWO Nürnberg im Kosovo und der Universität Prishtina – Abteilung für Soziale Arbeit – zur Einbindung von Praktikanten nahmen Anda Pallaska und Rinesa Behluli am 25. Mai 2026 an der Schulung „Der Prozess der Supervision von Studierenden im Praktikum“ teil, die von Bates Counseling Services in Prishtina durchgeführt wurde. Nach erfolgreichem Abschluss wurden sie zertifiziert.

Die Schulung konzentrierte sich auf die pädagogische, administrative und unterstützende Supervision von Praktikanten und behandelte Themen wie Orientierung, Evaluation, Lernvereinbarungen sowie die professionelle Entwicklung der Studierenden durch praxisorientierte Methoden und Gruppenaktivitäten.





Trajnim mbi mbikëqyrjen e praktikantëve nga Universiteti i Prishtinës

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet AWO Nürnberg në Kosovë dhe Universitetit të Prishtinës – Departamenti i Punës Sociale për angazhimin e studentëve praktikantë, Anda Pallaska dhe Rinesa Behluli morën pjesë më 25 maj 2026 në trajnimin “Procesi i Supervizimit të Studentëve në Praktikë”, të mbajtur në Prishtinë nga Bates Counseling Services, ku edhe u certifikuan.

Trajnimi u fokusua në supervizimin edukativ, administrativ dhe mbështetës të studentëve në praktikë, duke përfshirë orientimin, vlerësimin, marrëveshjet e të nxënit dhe zhvillimin profesional të praktikantëve përmes metodave praktike dhe aktiviteteve grupore.



Sommeraktivitäten für Kinder, Jugendliche und Mütter im Rahmen des Projekts KOMPASS

Im Rahmen des Projekts **KOMPASS** wurde während der heißen Sommertage eine Schwimmaktivität für Kinder und Jugendliche aus rückgekehrten Familien organisiert. Dabei erwarben sie theoretische Kenntnisse und praktische Fähigkeiten im Schwimmen und entwickelten diese nicht nur als sportliche Aktivität, sondern auch als wichtige lebenspraktische Kompetenz weiter. Ihre Fortschritte und die Freude in ihren Gesichtern zeigten, wie wertvoll und bereichernd diese Aktivität für sie war.


Gleichzeitig nahmen ihre Mütter an Gruppentreffen teil, bei denen sie die Möglichkeit hatten, ihre Erfahrungen und Herausforderungen während ihres Aufenthalts in Deutschland sowie im Zusammenhang mit ihrer Rückkehr und Wiedereingliederung im Kosovo auszutauschen. Die Treffen förderten den gegenseitigen Austausch, die Unterstützung untereinander und die Stärkung der Kontakte zwischen den Müttern und trugen damit zur nachhaltigen Wiedereingliederung der rückgekehrten Familien bei.



Aktivitete verore për fëmijët, të rinjtë dhe nënat përfituese të projektit KOMPASS

*Në kuadër të projektit **KOMPASS**, gjatë ditëve të nxehta të verës u organizua aktiviteti i pishinës dhe mësimit të notit për fëmijët dhe të rinjtë nga familjet e riatdhesuara. Përmes këtij aktiviteti, ata fituan njohuri dhe aftësi praktike në not, duke e zhvilluar atë jo vetëm si sport, por edhe si një shkathtësi të rëndësishme për jetën. Përparimi i tyre dhe buzëqeshjet në fytyrat e tyre dëshmuan për kënaqësinë dhe rëndësinë e këtij aktiviteti.*

Njëkohësisht, nënat e tyre morën pjesë në takime grupore, ku patën mundësi të ndanin përvojat dhe sfidat e tyre gjatë qëndrimit në Gjermani, si dhe gjatë kthimit dhe përshtatjes me jetën në Kosovë. Këto takime kontribuuan në shkëmbimin e përvojave, mbështetjen e ndërsjellë dhe forcimin e lidhjeve mes nënave, duke mbështetur procesin e riintegrimit të familjeve të riatdhesuara.



Um auch die nächsten Ausgaben mit spannenden Inhalten zu füllen und vor allem für alle Leser/-innen ansprechend zu gestalten, freuen wir freuen uns über Ihr Feedback!

Für Feedback oder wenn Sie vom Newsletter an- oder abgemeldet werden wollen, klicken Sie bitte hier.

Për t'u siguruar që numrat e ardhshëm të jenë të mbushur me përmbajtje interesante dhe - mbi të gjitha - tërheqës për të gjithë lexuesit tanë, do të na pëlqente të dëgjonim reagimet tuaja!

Për reagime, ose nëse dëshironi të regjistroheni ose të çregjistroheni nga buletini, ju lutemi klikoni këtu.

Impressum

AWO Kreisverband Nürnberg e.V.
Karl-Bröger-Straße 9
90459 Nürnberg

E-Mail: kreisverband@awo-nbg.de

Verantwortlich i. S. d. § 18 Abs. 2 MStV (V.i.S.d.P.): Martina Sommer

Vollständiges Impressum:
www.awo-nuernberg.de/impressum